



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ROSKOVEC
KRYETARI

Nr. 9137 Prot

Roskovec, më 10.10.2022

**SHPALLJE PËR VEND TË LIRË PUNE
PËR POZICIONIN**

PUNONJËS NË POLICINË BASHKIAKE ROSKOVEC

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”; të ligjit Nr.8224, datë 15.5.1997 “Për organizimin dhe funksionimin e Policisë së Bashkisë dhe Komunës” (i ndryshuar); nenit 11 të Rregullores së brendshme “Tip” të policisë së bashkisë dhe komunës; VKM-së Nr. 525, datë 11.9.2018, “Për disa ndryshime në vendimin Nr. 313 datë 1.7.2002 të Këshillit të Ministrave “Për caktimin e strukturës, të numrit të punonjësve dhe shpezimeve buxhetore të policisë së bashkisë dhe komunës”, të ndryshuar; Vendimit të Keshillit Bashkiak nr. 103 datë 24.12.2021 “Për miratimin e buxhetit , numrit maksimal të punonjësve të Bashkisë dhe të Ndërrmarjeve vartëse të bashkisë për vitin 2022”, miratuar nga Prefekti i Qarkut Fier me shkresë nr.03/1, datë 11.01.2022; Vendimit të Kryetarit të Bashkisë Roskovec Nr.22, datë 01.02.2022 “Për Miratimin e Strukturës Organizative dhe Pagat Përkatëse për Bashkinë Roskovec dhe Njësitë Administrative Kuman, Kurjan dhe Strum për vitin 2022”, Bashkia Roskovec shpall procedurën e konkurimit për vend të lirë pune,

Punonjës i policisë bashkiake, (2 polic)

Kandidatët për polic duhet të plotësojnë kërkesat e posaçme si vijon:

- Të jetë shtetas shqiptar;
- Të kenë të kryer arsimin e mesëm;
- Të jetë i moshës nga 19-27 vjeç;
- Të jetë në gjendje të mirë shëndetësore dhe i aftë fizikisht e mendërisht për të vepruar;
- Të ketë cilësi të larta morale e qytetare;
- Të mos jetë i dënuar nga organet gjyqësore dhe të drejtësisë me vendim të formës së prerë;
- Preferohet të ketë punuar në policinë e shtetit dhe të mos ketë qënë i dënuar për shkelje të rënda dhe vepra penale;

DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT

Kandidatët duhet të dorëzojnë dokumentat si më poshtë;

- a- Kërkesë për aplikim (me shkrim dore);
- b- Curriculum Vitae;
- c- Fotokopje e Kartës së Identitetit;
- d- Çertifikatë e përbërjes familjare;
- e- Librezë ushtarake ose vërtetim nga dega e mobilizimit ushtarak;

- f- Fotokopje e diplomës së shkollës dhe lista e notave e noterizuar;
- g- Çertifikata kualifikimi të ndryshme (në rast se ka);
- h- Fotokopje e librezës së punës.
- i- Motivacioni i largimit nga puna e fundit (në se është i punësuar ose ka qenë i punësuar);
- j- Raport mjeko-ligjor për ushtarakë;
- k- Vërtetim i gjendjes Gjyqësore;
- l- Vërtetim nga prokuroria (që nuk është aktualisht në proces hetimi);
- m- Vërtetim nga Gjykata (që nuk është aktualisht në proces gjyqësor);
- n- Vërtetim nga Drejtoria e Tatim-Taksave (që nuk është person fizik dhe juridik);
- p- 2 Fotografi (një copë 9 x 6 cm dhe një copë 2.5 x 3.5 cm).

Dokumentat duhet të dorëzohen me postë ose në Sektorin e Zyrës me Një Ndalesë të bashkisë Roskovec, brenda datës **18.10.2022**.

REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK TË DOKUMENTACIONIT

Në datën **20.10.2022**, Njësia e Burimeve Njerëzore në Bashkinë e Roskovecit do të shpallë në faqen e internetit të Bashkisë Roskovec, në stendat e informimit të publikut, listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet dhe kërkesat e posaçme, si dhe datën, vendin dhe orën e saktë kur do të zhvillohet testimi. Kandidatët e skualifikuar kanë të drejtë të ankimohen pranë Njesisë së Burimeve Njerëzore të Bashkisë Roskovec. Afati i ankimimit është **2 ditë** nga data e shpalljes së rezultateve të verifikimit.

FUSHAT E NJOHURIVE, AFTËSITË DHE CILËSITË MBI TË CILAT DO TË ZHVILLOHET TESTIMI

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:

- a- Njohuritë mbi ligjin nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”;
- b- Njohuritë mbi ligjin nr.8224, datë 15.5.1997 “Për organizimin dhe funksionimin e Policisë së Bashkisë dhe Komunës” (i ndryshuar);
- c- Njohuritë mbi Rregulloren së Brendshme “Tip” të policisë së bashkisë dhe komunës;
- d- Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë.

MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me dokumentacionin e dorëzuar:

Kandidatët do të vlerësohen për përvojën, trajnimet apo kualifikimet e lidhura me fushën.

Kandidatët në testimin me shkrim dhe intervistën me gojë do të vlerësohen në lidhje me:

- a- Njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me punën;
- b- Eksperiencën e tyre të mëparshme;
- c- Motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën.

Totali i pikëve për vlerësimi e kandidatëve është **100 pikë** i detajuar si më poshtë:

Vlerësimi maksimal për dokumentacionin është	25 pikë
Vlerësimi maksimal për testimin me shkrim është	45 pikë
Vlerësimi maksimal për intervistën me gojë është	30 pikë

Kandidatët që marrin 60% (27 pikë) të pikëve të testimit me shkrim, kanë të drejtë të vazhdojnë fazën e intervistës me gojë.

DATA E DALJES SË REZULTATEVE TË KONKURIMIT DHE MËNYRA E KOMUNIKIMIT

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, (testimit me shkrim dhe intervistës me gojë) Njësia e Burimeve Njerëzore në Bashkinë e Roskovecit do të shpallë fituesit në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit” në faqen e internetit të Bashkisë Roskovec në stendat e informimit të publikut dhe në stendat pranë Policisë Bashkiake. Kandidatët jo fitues kanë të drejtë të ankimohen pranë Njesisë së Burimeve Njerëzore të Bashkisë Roskovec. Afati i ankimit është **5 ditë** nga data e shpalljes së rezultateve të testimit.

KRYETARI

Majlinda Buri

